



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina

EKSTRAKT I PROCESVERBALIT

të mbledhjes së shtatë të Komitetit për Politikë dhe Financa, mbajtur më 12.12.2016, e cila filloi në orën 15:00.

Në mbledhje morën pjesë: Halim Halimi, kryesues i Komitetit, Agim Gashi shef i GP të LDK – së, Hazir Borovci, përfaqësues i LDK-së, Besa Rafuna, përfaqësuese e LDK-së, Qëndron Kastrati, shef i GP të LVV-së, Hatixhe Hoxha, përfaqësuese e LVV-së, Lirak Çelaj, shef i GP të PDK-së, Laura Zherka, përfaqësuese e PDK-së, Mirlinda Sopi, shefe e GP të AKR-së.

Munguan: Brahim Mehmetaj, shef i GP të AAK-së dhe Cuneyd Ustaibo, përfaqësues i subjektit politik KDTP.

Të pranishëm ishin edhe: Agim Salihu, asistent i kryesuesit të Kuvendit të Komunës, Ardian Olluri, shef i Zyrës ligjore, Muhedin Nushi, drejtor i Drejtorisë së Administratës, Genc Bashota, drejtor i Drejtorisë së Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm, Ismail Kokaj, drejtor i Drejtorisë së Financave, Dren Kukaj, drejtor i Drejtorisë së Pronës, Ferat Makolli, drejtor i Drejtorisë së Bujqësisë, Gent Begolli, drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike, Mbrojtjes dhe Shpëtimit dhe përfaqësuesi i OSBE-së.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi **Halim Halimi**, kryesues.

Për këtë mbledhje u propozua ky

REND I DITËS:

1. Miratimi i ekstraktit të procesverbalit të mbledhjes së gjashtë të Komitetit për Politikë dhe Financa;
2. Propozimvendimi për lënie në diskutim publik të Rregullores për organizimin dhe bashkëpunimin e Komunës me fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane në territorin e komunës së Prishtinës;
3. Shqyrtimi i Raportit të auditimit të përgjithshëm për vitin 2015;

4. Caktimi i një anëtari në Komisionin Komunal të Aksionarëve të NPL "Hortikultura" SHA dhe NPK "Trafiku Urban" SHA Prishtinë;
5. Propozimvendimi për rikategorizimin e parkut rajonal natyror "Gërmia" në kategorinë - peizazh i mbrojtur;
6. Propozimvendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës me pronën e paluajtshme në pronësi të personave fizikë/juridikë;
7. Propozimvendimi për themelimin e grupit punues të Kuvendit të Komunës për hartimin e planit të punës së Kuvendit për vitin 2017;
8. Propozimvendimi për ndryshimin e Vendimit për Komitetin për Komunitete;
9. Të ndryshme.

Njëzëri u miratua rendi i ditës.

Pika e parë

Miratimi i ekstraktit të procesverbalit të mbledhjes së gjashtë të Komitetit për Politikë dhe Financa.

Halim Halimi, kryesues, bëri vërejtje në ekstrakt, duke thënë se ekstrakti është i palekturuar, andaj kërkoj që të lekturohet, sepse mbetet si dokument.

Kryesuesi konstatoi se u miratua ekstrakti i procesverbalit të mbledhjes së gjashtë të Komitetit për Politikë dhe Financa.

Pika e dytë

Propozimvendimi për lënie në diskutim publik të Rregullores për organizimin dhe bashkëpunimin e Komunës me fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane në territorin e komunës së Prishtinës.

Muhedin Nushi informoi lidhur me këtë rregullore, duke bërë të ditur se kanë pasur takime me kryetarët e BL-ve, dy takime, ku i kanë dhënë vërejtjet e tyre në përmirësimin e Rregullores së kaluar dhe është formuar komisioni prej subjekteve politike me numër më të madh të anëtarëve të përfaqësuar në Kuvendin e Komunës. Tani e kemi Rregulloren finale, e cila do të prezantohet për dëgjim publik.

Agim Salihu bëri të ditur se janë mbajtur disa punëtori të grupit punues. Natyrë e grupit punues ka qenë të hartojë një rregullore, e cila është në pajtim me ligjet dhe aktet nënligjore në fuqi që kanë të bëjnë me këtë fushë. Në bazë të dispozitave në fuqi, kërkohet që kjo rregullore të dërgohet në diskutim publik.

Lirak Çelaj u shpreh se, meqë është për dëgjim publik, nuk kemi vërejtje, pasi që është parim dhe besoj se shumica është në rregull. Kur të bëhen zgjedhjet lokale, do të ishte mirë të kishte zgjedhje për këshilla të BL-ve, që të jetë proces më i legjitimuar.

Lidhur me formulën e përfaqësimit të këtij komisioni, pyeti se a ka ndonjë nen të ligjit që parasheh këtë punë.

Në bazë të kësaj që shkruan në Rregullore, ata që janë të zgjedhur në poste politike, nuk mund të jenë kandidatë për pozita të anëtarëve dhe të kryetarëve të këshillave lokalë. Këtë ndalesë unë e kisha hequr. Meqë ne nuk ia sanksionojmë shoqërisë civile mundësinë e përfaqësimit me një anëtar, unë mendoj se nuk duhet sanksionuar as subjektet politike.

Halim Halimi, kryesues, theksoi se në Rregullore, te neni 4, pika 1, thuhet: “Komisioni duhet të ketë 7 anëtarë: tre anëtarë nga Kuvendi i Komunës, një nga shoqëria civile dhe një nga përfaqësuesit e fshatit”, këtu bëjnë gjithsej pesë anëtarë, andaj të shikohet kjo pikë.

Muhedin Nushi dha sqarime, duke thënë se tani është përmirësuar në material, pra është 7 anëtarë: pesë anëtarë nga Kuvendi i Komunës, një nga shoqëria civile dhe një nga përfaqësuesit e fshatit, vendbanimit apo lagjes urbane.

Lirak Çelaj kërkoi të dijë se kush e cakton anëtarin nga shoqëria civile.

Muhedin Nushi tha se kam menduar me qenë nga INFO, që është monitoruese e punës së Kuvendit komunal, pra përfaqësuesi i INFO-së me qenë përfaqësues i shoqërisë civile.

Osman Billaca dha sqarime, duke thënë se është rrjeti i platformës së shoqërisë civile Civikos, ku të gjitha organizatat janë të anëtarësuara në atë rrjet dhe aty mund të kërkohet nga Kuvendi Komunal një përfaqësues për monitorim të zgjedhjes së anëtarëve të BL-ve dhe ata e dërgojnë emrin e pastaj votohet në Kuvend.

Halim Halimi, kryesues, theksoi se është mirë që administrata t’i drejtohet zyrtarisht Civikos me i propozuar 5-6 emra të mundshëm për anëtar të Komisionit, që të ketë mundësi Kuvendi të përcaktohet për njërin nga të propozuarit, kështu që vendimi merret më së lehti në këtë mënyrë.

Kryesuesi konstatoi se njëzëri u përkrah Propozimvendimi për lënien në diskutim publik të Rregullores për organizimin dhe bashkëpunimin e Komunës me fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane në territorin e komunës së Prishtinës dhe i dërgohet Kuvendit për shqyrtim.

Pika e tretë

Shqyrtimi i Raportit të auditimit të përgjithshëm për vitin 2015;

Lirak Çelaj theksoi se, meqë ne nuk jemi forum që marrim vendim, propozoj që në Kuvend të diskutohet për Raportin e auditimit, meqë këtu nuk mund të ndërhyhet për ndryshim në raport, sepse këtu nuk e kemi auditorin.

Agim Gashi theksoi se përfaqësuesit e LDK-së nuk do të debatojmë për këtë pikë këtu, në Kuvend do të shtrohen çështjet, do t’i parashtrojmë pikëpamjet tona lidhje me raportin.

Kryesuesi konstatoi se njëzëri u përkrah shqyrtimi i Raportit të auditimit të përgjithshëm për vitin 2015 dhe i dërgohet Kuvendit për shqyrtim.

Pika e katërt

Caktimi i një anëtari në Komisionin Komunal të Aksionarëve të NPL “Hortikultura” SHA dhe NPK “Trafiku Urban” SHA Prishtinë.

Halim Halimi, kryesues, theksoi se ndryshohet vendimi, sepse në NPL "Hortikultura", SHA, ka qenë anëtare Lirjeta Rexhepi, e në vend të Lirjetës subjekti politikë i PDK-së do ta caktojë një anëtar tjetër.

Po ashtu, në NPL "Trafiku Urban", SHA, ka dhënë dorëheqje Shiqeri Spahiu, andaj duhet të përcaktohet dikush nga subjekti politikë i LDK-së.

Kryesuesi konstatoi se njëzëri u përkrah caktimi i një anëtari në Komisionin Komunal të Aksionarëve të NPL "Hortikultura", SHA, dhe NPK "Trafiku Urban", SHA, Prishtinë dhe i dërgohet Kuvendit për shqyrtim.

Pika e pestë

Propozimvendimi për rikategorizimin e parkut rajonal natyror "Gërmia" në kategorinë - peizazh i mbrojtur.

Genc Bashota dha sqarime, duke cekur se Kuvendi ka marrë vendim për rikategorizimin e parkut në peizazh të mbrojtur, në ndërkohë Ministria e ka kthyer mbrapa vendimin me dy vërejtje: e para, për një hartë, të cilën ata e kanë kërkuar dhe me ligj është dashur me qenë 1:25.000 lokacioni, dhe vërejtja e dytë ka qenë vërejtja e qytetarëve të shumtë, të cilët kanë prona private në atë pjesë. Kemi pasur disa takime me Ministrinë, kemi dhënë një propozim dhe kemi punuar me planifikim, kemi hequr 355 hektarë prej zgjerimit të mëhershëm, që janë prona private të fshatit Zllatar. Në takimet që kemi pasur, Ministria ka kërkuar që propozimin e ri që e kemi dhënë, me kaluar në Kuvend para Vitit të Ri dhe nuk do të ketë asnjë telashe.

Agim Gashi tha se edhe më herët ka qenë pjesa e parkut dhe pjesa e mbrojtur, tash janë integruar në peizazh i mbrojtur, ajo nuk përfshin vetëm Zllatarin, por edhe pjesë të tjera ku ka mjaft prona private, andaj është mirë të trajtohen mirë ato pjesë, sepse është pjesa më atraktive, e sidomos Butovci meriton me u trajtuar mirë dhe me u ruajtur.

Qëndron Kastrati kërkoi nga Kadastru që t'u sigurojë, në mënyrë zik-zake, një historik të pronave private, në mënyrë që të dihet se prej kur janë ato prona private.

Lirak Çelaj bëri të ditur se në parim e përkrahin. Sa i përket pronave private, ai shtroi pyetjen se a do të bëhet kompensim, cila është e drejta e tyre në pronë, a është e përcaktuar me ligj, a kompensohen ato prona? Sa i përket asaj që e tha Qëndroni, është shqetësim për tërë territorin e komunës së Prishtinës, mirëpo janë gjykatat, nëse ka dyshim, për secilin rast me filluar procedurat gjyqësore, se ne nuk jemi organ përkatës që vendosim se a e ka tjetërsuar dikush në mënyrë të ligjshme apo jo.

Kryesuesi konstatoi se njëzëri u përkrah Propozimvendimi për rikategorizimin e parkut rajonal natyror "Gërmia" në kategorinë - peizazh i mbrojtur, me propozimin e Qëndronit, dhe i dërgohet Kuvendit për shqyrtim.

Pika e gjashtë

Propozimvendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës me pronën e paluajtshme në pronësi të personave fizikë/juridikë.

Dren Kukaj dha sqarime lidhur me këtë propozimvendim, duke cekur se kjo ka qenë kërkesë e Drejtorisë së Arsimit, por për shkak të mungesës së mjeteve financiare për t'i shpronësuar pronat private, se është paraparë me Plan rregullues ndërtimi i shkollës, është dashur të gjejmë forma të këmbimit të pronës. Këto janë dy prona që i ka identifikuar për këtë qëllim dhe ne si Drejtori e Pronës e kemi përgatitur materialin.

Lirak Çelaj pyeti se a ndërlihet kjo me atë peticionin e banorëve të lagjes "Prishtina e Re", sepse aty ka qenë, ata pikërisht kanë thënë se aty në pronë private është caktuar ndërtimi i një shkolle dhe, në anën tjetër, ka qenë arsyetimi se nuk ka mjete dhe nuk është lejuar qasja që ata ta shfrytëzojnë atë pronë private dhe ka mbetur pezull çdo gjë, andaj mendoj se kjo është një shkelje e të drejtave të shfrytëzimit të pronës.

Dren Kukaj dha sqarime lidhur me pyetjen e Lirakut.

Qëndron Kastrati tha se pronar fizik është Bajram (Nasuf) Gashani dhe pa pajtimin e palës nuk mundesh me bërë këmbimin e pronës, pra pala është pajtuar.

Agim Gashi theksoi se edhe kur nuk ka pasur Plan rregullues, është tentuar në atë pjesë të fillojë ndërtimi i një shkolle te pronat e PIK-së në anën e djathtë të Veternikut, ndërsa Plani rregullues e paska paraparë në këtë parcelë, ku pritet të bëhet ndërtimi i parcelave.

Ardian Olluri dha sqarime, duke cekur se planifikimi nuk është bërë për shpronësim. Shpronësimi bëhet kur bëhet projekti, kur i kufizohen, i merren të drejtat pronarit në pronë, në planifikim nuk i kufizohen të drejtat pronarit.

Mirlinda Sopi tha se në vitin 2013 është dashur me u analizuar mirë qyteti, e pastaj me bërë plane rregulluese. Kjo pikë është e kryer. Pse po diskutojmë e po humbim kohë kur Komuna është marr vesh me pronarin!

Halim Halimi, kryesues, theksoi se me rëndësi është aspekti ligjor, nëse jemi në rregull në aspektin ligjor, atëherë nuk ka problem. Kërkoj sqarime nga Zyra ligjore se a mundet kur e ka të drejtën ai shfrytëzues që e ka me qirambajtje për 99 vjet, me u bërë këmbimi.

Ardian Olluri tha se përgjigjen do ta jap në Kuvend lidhur me këtë çështje.

Qëndron Kastrati e përkrahu kërkesën e kryesuesit, sepse kjo çështje është e ndjeshme dhe duhet analizuar mirë. Ai tha se këmbimi i pronës bëhet realisht në vlerën financiare, që është një komision që nuk e ndan tokë me tokë, metër me metër, por e kthen në vlerë financiare. Vlera financiare ka me qenë e njëjtë, që nuk do me thënë se sipërfaqja ka me qenë e njëjtë.

Kryesuesi konstatoi se njëzëri u përkrah dërgimi për Kuvend i Propozimvendimit për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës me pronën e paluajtshme në pronësi të personave fizikë/juridikë, me kusht që Zyra ligjore të shpjegojë në detale këtë këmbim të pronës në Kuvend.

Pika e shtatë

Propozimvendimi për themelimin e grupit punues të Kuvendit të Komunës për hartimin e planit të punës së Kuvendit për vitin 2017.

Halim Halimi, kryesues, tha se në vitin e kaluar ka qenë një grup punues, i përbërë prej 13 anëtarëve. Pasi bëri leximin e emrave të anëtarëve të këtij komisioni, theksoi se nëse ka ndonjë vërejtje në këtë përbërje, mund të bëjmë ndryshime.

Qëndron Kastrati bëri të ditur se Grupi i tij parlamentar e propozon të njëjtin grup punues.

Agim Gashi e përkrah propozimin që të jetë i njëjti grup punues.

Laura Zherka propozoi të mos jetë ajo në grup punues, por Lirie Avdiu.

Kryesuesi konstatoi se njëzëri u përkrah Propozimvendimi për themelimin e grupit punues të Kuvendit të Komunës për hartimin e planit të punës së Kuvendit për vitin 2017 dhe i dërgohet Kuvendit për shqyrtim.

Pika e tetë

Propozimvendimi për ndryshimin e Vendimit për Komitetin për Komunitete;

Lirak Çelaj e propozoi znj. Lirie Avdiu të jetë anëtare e Komitetit për Komunitete.

Kryesuesi konstatoi se njëzëri u përkrah Propozimvendimi për ndryshimin e Vendimit për Komitetin për Komunitete dhe i dërgohet Kuvendit për shqyrtim.

Pika e nëntë

Të ndryshme.

Lirak Çelaj kërkoi që t'u dërgohen të gjithë këshilltarëve, nëse ka mundësi në mënyrë retroaktive për vitin 2016, konfirmimet dhe jo konfirmimet që kanë të bëjnë me ligjshmërinë e vendimeve që i marrim, si dhe vendimet se si janë përpiluar format, se si janë dërguar në Ministri.

Halim Halimi, kryesues, u tha të pranishmëve se tani e mora një propozimvendim për plotësimin e Rregullores për qoshqe, që të futet si pikë e rendit të ditës për seancë të Kuvendi, pra të jetë si pikë e rendit të ditës për Kuvend.

Qëndron Kastrati propozoi që të jetë pikë e rendit të ditës për Kuvend "Informatë për suksesin dhe rezultatin e nxënësve, të arritur në tri nivelet e arsimit parauniversitar, gjatë vitit shkollor 2015 / 2016".

Mbledhja përfundoi në orën 16:05.

Procesmbajtësja:
Shyhrete Islami

Kryesuesi i Komitetit
Halim Halimi, jur. i dipl.